REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 2806/16 prot. Pogradec, më 29.07.2025

VENDIM

NR. 70, DATË 28.07.2025

PËR
NJË SHTESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 105, DATË 02.12.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE" DHE "HARTA QË PËRCAKTON RRUGËT E QYTETIT , TË CILAT PËRJASHTOHEN NGA KJO RREGULLORE", I NDRYSHUAR.

Në mbështetje të nenit 8, pika 1, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "a", nenit 23, pika 14, nenit 54, shkronja "k", nenit 64, shkronjës "c" të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 4/1 të Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", i ndryshuar, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, nenit 10, nenit 11, nenit 15 dhe nenit 17 të VKM-së nr. 1096, datë 28.12.2015 "Për miratimin e rregullave, kushteve e proçedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike", i ndryshuar,

VENDOSI:

**1.** Të miratojë në nenin 7 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 105, datë 02.12.2021 për "Miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave publike" dhe "Harta që përcakton rrugët e qytetit ,të cilat përjashtohen nga kjo rregullore", i ndryshuar",

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

shtimin e shkronjës f) *Nuk lejohet tregëtimi i produkteve të ndryshme të përdoruara (si veshje, këpucë, aksesorë, lodra etje) në ambjentet e hapura, qofshin këto publike dhe jopublike."*

**2.** Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Policia Bashkiake për zbatimin e këtij vendimi.

**3.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

**KRYETARE E KËSHILLIT**

**Manjola KAMOLLI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

**1.Miratuar me** 17 **vota**

**2.Vota Pro** 17

**3.Vota Kundër** 0

**4.Vota Abstenim** 2

**5.Zbardhur më date** 29.07.2025

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com